



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju / Kosovo Competition Authority

Analizë Sektoriale

Tregu i Telekomunikimeve Elektronike dhe Postare

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
27 DHJETOR 2019
Prishtinë

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	3
- Pasqyrë e Përgjithshme e tregut të komunikimeve elektronike	4
- Pasqyra e të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike.....	6
- Indikatorët kryesorë të tregut të komunikimeve elektronike 2016-2017	6
I. Telefonia Fikse	7
- Numri i përdoruesve të telefonisë fikse 2016-2017.....	8
II. Telefonia Mobile	9
- Trafiku i origjinuar nga rrjetet e telefonisë mobile 2016-2017.....	9
- Trafiku i terminuar në rrjetet e telefonisë mobile 2016-2017.....	9
- Përdorimi mesatar i shërbimeve të telefoniSë mobile për një përdorues 2016 – 2017...10	
III. Interneti	11
- Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit	11
IV. Pasqyra e përgjithshme e tregut të shërbimeve postare.....	12
V. Kuadri Ligjor.....	12
VI. Pengesat e hyrjes në treg	13
- Gjetja e mundësive më të mira për sektorin e telekomunikacionit.....	13
VII. Konstatimet	15

Përmbledhje Ekzekutive

Analiza Sektoriale e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ofron të dhëna mbi të arriturat e deritashme, objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara me ligjet përkatëse dhe dokumentin e politikave të sektorit të komunikimeve elektronike. Analiza gjithashtu paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për tregun përkates.

Sektori i telekomunikacionit karakterizohet jo vetëm si faktor i zhvillimit ekonomik, por edhe si stimulues në zhvillimin e ekonomive të tjera, me theks tek sektori i inovacioneve dhe shoqërisë së informacionit. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, për palët e interesuara (operator dhe ofruesve të licensuar) opinionit të gjerë, e ka hartuar këtë Raport për gjendjen në tregun përkates, i cili përmbanë treguesit kryesor të Tregut të Telekomunikimeve nga aspekti i konkurrencës.

Bazuar në të dhënat e siguruar nga rregullatori për vitin 2016-2017, tek pjesa e nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve, si një nga parakushtet thelbësore për nxitjen e investimeve, vërehet se kemi cilësinë e duhur të shërbimeve me çmime të arsyeshme dhe oferta konkurruese për përdoruesit-konsumatorët duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe konkurrueshmëri në mes të operatorëve.

Shikuar nga prizmi i zhvillimeve në tregun e komunikimeve elektronike, vërehet se tek të ardhurat nga shërbimet e ofruara nga rrjetet e komunikimeve elektronike në vitin 2016-2017, ka një ngritje të lehtë, e cila i atribuohet rritjes së të ardhurave nga shërbimet e qasjes në internet.

Sektori i Tregut të Telekomunikacionit gjatë vitit 2017 konsiderohet si burim shumë i rëndësishëm për aktivitetet ekonomike të nënsektorëve të tregut të telekomunikacionit si:

- Sektori i shërbimeve fikse
- Sektori i shërbimeve mobile
- Sektori i ofrimit të internetit dhe
- Sektori i shërbimeve postare.

Analiza mbledh informacione kryesisht nga tregu përkates dhe Rregullatori, duke marrë për bazë edhe vlerësimet e tyre në situatën ekonomike si dhe parashikimet e tyre në të ardhmen dhe si e tillë, ofron një pasqyrë të detajuar të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës.

LPASQYRË E PËRGJITHSHME E TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Tregu i komunikimeve elektronike vazhdon me trende pozitive, në disa segmente të tij, siç është rritja e numrit të përdoruesve të shërbimeve mobile dhe të internetit. Mbizotron ambient konkurrues, mundësuar nga liberalizimi i tregjeve në përputhje me Ligjin e Komunikimeve Elektronike, sipas parimeve të politikës së konkurrencës.

Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazohet në parimin e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të resurseve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kritereve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mos-diskriminim.

ARKEP-i si rregullator në procesin e rregullimit të tregut i trajton në mënyrë të barabartë të gjitha ndërmarrjet dhe nuk i diskriminon mbi bazën e ndarjes në mes të atyre publike apo private. Rregullatori në përputhje me Kornizën Rregullatore, pas procesit të analizës së tregut, u vendos detyrime shtesë (Rregullimi asimetrik *ex-ante*), ashtu që të mos abuzojnë me pozitën që kanë.

Sa u përket tregjeve, subjekt i analizës dhe rregullimit *ex-ante*, njëra nga detyrimet rregullatore të vendosura nga ARKEP është detyrimi i kontrollit të çmimit dhe llogaritjes së kostos sipas dispozitave të nenit 35 të Ligjit të Komunikimeve elektronike dhe Rregullores nr.27 për analizat e tregut. Per përcaktimin e çmimit ekzistojnë modele të ndryshme, të cilat aplikohen si: pure LYRIC, metoda e shpërndarjes së plotë e kostos (FDC), efikasitetit krahasues (Benchmarking), etj. ARKEP deri më tani në procesin e analizës dhe rregullimit të tregjeve ka aplikuar metodën FDC dhe efikasitetit krahasues përmes aplikimit të modelit të përshkallëzimit gradual (Glide Path).

Në tregun e komunikimeve elektronike, numri i operatorëve, të cilët janë regjistruar në regjistrin e autorizimeve të përgjithshme për vitin 2017 është 110 me gjithsej 232 aktivitete, ndërsa në tregun e shërbimeve postare operojnë aktualisht gjithsejtë 15 Operatorë postar.

Sa u përket resurseve të kufizuara (numerike dhe frekuencore), aplikohen autorizimet individuale, përkatësisht pagesa të caktuara. Duke pasur parasysh faktin se të hyrat e operatorëve janë duke pësuar rënie (kryesisht nga telefonia mobile dhe fikse), si sfida kryesore e adresuar është zvogëlimi i tarifave të resurseve të kufizuara (frekuencore dhe numerike).

Korniza aktuale rregullatore ka eliminuar barrierat e panevojshme për hyrje në treg nga investitorët e ri. Regjimi i licencave individuale është zëvendësuar me regjimin e autorizimeve të përgjithshme. Prezenca e më shumë se një operatori në treg për ofrimin e produkteve/shërbimeve të ngjashme, konsiderohet se tregu është konkurrues, me c'rast rregullatori pas vlersimeve në treg me qëllim të eliminimit të barrierave për hyrësit e ri në treg ka vendosur detyrime rregullatore ex-ante për ndërmarrjen me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse.

Operatorët e telefonisë mobile dhe ofruesit e shërbimeve të internetit zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të telekomunikimeve elektronike me rreth 80% të të ardhurave, operatorët mobil përbëjnë 64.32% të të ardhurave të të gjithë tregut, duke u përcjellur nga ofruesit e shërbimeve të internetit me 16.49%, televizioni kabllor 13.22% ,ndërsa operatorët fiks 5.60 %.

Në segmentin e telefonisë mobile, dy operatorët kryesorë të rrjeteve mobile zotërojnë rreth 93.4% të të ardhurave të gjithë segmentit të telefonisë mobile, ndërsa dy operatorët virtual zotërojnë rreth 4.7% të të ardhurave të segmentit të telefonisë mobile. Të ardhurat e operatorëve mobil (*përshirë këtu operatorët e rrjetës dhe ata virtual*) përfaqësojnë mbi 74% të të ardhurave të gjithë tregut të komunikimeve elektronike.

Gjatë vitit 2017, numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur shifrën prej 2,032,182 (TM4 2017), që krahasuar me fundin e vitit 2016 është shënuar rritje prej 22,234 përdoruesish ose shprehur në përqindje paraqet një rritje prej 1.1%.

Kjo rritje bazohet në zhvillimin e teknologjisë dhe rritjes së përdorimit të telefonave të mençur nga përdoruesit e telefonisë mobile të cilat mundësojnë përdorimin e aplikacioneve të bazuara në platformën e internetit për qëllime të komunikimit. Sipas shënimeve të operatorëve të telefonisë mobile vlerësohet se në Kosovë mbi 30% të përdoruesve të telefonisë mobile shfrytëzojnë telefona të mençur mobil të cilët mundësojnë dhe përkrahin përdorimin e aplikacioneve të internetit.

Përveç tregut të thirrjeve në rrjetet fikse dhe mobile, të cilët për shkak të pengesave teknologjike konsiderohet si monopol natyror, në tregjet tjera të komunikimeve elektronike konsiderohet se tregu është konkurrues në nivel shërbimi, madje në tregun e shërbimeve të internetit dhe telefonisë fikse, tregu është konkurrues, (të gjithë operatorët në treg operojnë bazuar në infrastrukturën vetanake.

Të hyrat nga shërbimet e Komunikimeve elektronike për vitin 2017 arrijnë vlerën 169,134,346 Euro, me një rritje prej 0,4 % në krahasim me vitin 2016.

Pasqyra e të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike

Nr.	Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi në krahasim me vitin 2016 (%)
1	Të hyrat (€)	169,134,346	168,347,895	▲ 0.4%
2	Telefonia fikse	9,509,340 €	9,307,906 €	▲ 2.16%
3	Telefonia mobile	108,799,157 €	112,257,818 €	▼ 3.08%
4	Linjat me qira	565,238 €	523,171 €	▲ 8.04%
5	Qasja në internet	27,896,605 €	22,489,433 €	▲ 24.04%
6	TV kabllor ¹²	22,364,006	23,769,620	▼ 5.91%

INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE 2016-2017

Nr.	Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi në krahasim me vitin 2016 (%)
1	Numri i linjave të telefonisë fikse në fund të viteve	334,452	334,452	—
2	<i>Numri i përdoruesve të telefonisë fikse</i>	63,816	53,011	▲ 20.38 %
3	<i>Penetrimi i telefonisë fikse (%)</i>	3.51%	2.92%	▲ 20.2%
4	Numri i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të viteve	2,032,182	2,009,848	▲ 1.1 %
5	<i>Penetrimi i telefonisë mobile (%)</i>	111.93%	110.7%	▲ 1.1%
6	Numri i përdoruesve të internetit në fund të viteve - Qasja Fikse	274,743	239,392	▲ 14.7%
7	<i>Penetrimi i shërbimeve të internet-it (%)</i>	15.13%	13.2%	▲ 14.62%

Investimet e bëra nga operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2017 arrijnë vlerë afër € 31.22 mln, që shënon një rritje krahasuar me vitin e kaluar, ku investimet kanë qenë mbi € 29.75 mln, ose e shprehur në përqindje ka një ngritje të lehtë prej 4.9% të investimeve krahasuar me vitin 2016. Investimet në segmentin e telefonisë mobile përbëjnë 49% të investimeve totale të tregut të komunikimeve elektronike, pjesën tjetër e përbëjnë investimet në infrastrukturën fikse të cilat përdoren për ofrimin e shërbimeve me qasje në internet dhe TV kabllor, dhe 4% investimet në telefoninë fikse

Shërbimet Postare: Shërbime postare konsiderohen shërbimet e kryera nga ofruesi i shërbimit (Operatori) sipas kërkesës së shfrytëzuesit (konsumatorit) kundrejt pagesës së taksës postare e që nënkuptohet: pranimi, përpunimi, bartja - transporti, shpërndarja dhe dorëzimi i dërgesave postare.

II. Telefonia Fikse

Tregjet me pakicë:

- a) Qasja në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse,
- b) Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fiks,
- c) Shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fiks.

Tregjet me shumicë:

- a) Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruara në një lokacion fiks
- b) Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fiks
- c) Shërbimet transite në rrjetet publike telefonike fikse
- d) Qasjen me shumicë në Infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë qasjen e ndarë, të pjesshëm dhe të plotë) për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese

Tregu i telefonisë fikse vazhdon të zhvillohet me ritme të ngadalësuar njejtë si në vendet e rajonit dhe BE.

Në tregun e telekomunikimeve operojnë katër operatorë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese fikse;

- Telekomi i Kosovës Sh.A (ish PTK -),
- IPKO Telecommunications LLC,
- Kujtesa.Net,
- Fiberlink (nuk ka filluar me shërbime)

Lehtësirat e krijuara kanë mundësuar hyrjen e operatorëve të rinjë në tregun e telefonisë fikse, gjë që jep sinjal të kuptojmë se kemi të bëjmë me liberalizim të plotë të tregjeve të komunikimeve elektronike.

Krahasuar me ritmet e zhvillimit të tregut të telefonisë mobile dhe shërbimeve të internetit në Kosovë, edhe përkundër investimeve të bëra në këtë sektor, niveli i mbulimit të territorit dhe popullsisë me shërbime të telefonisë fikse mbetet shumë i ulët, e si faktor kryesor për këtë gjendje, kryesisht është kërkesa e ulët për këto shërbime, si dhe kompleksiteti i punëve, nevoja për investime të mëdha etj.

Numri i përdoruesve të telefonisë fikse 2016-2017

Nr.	Viti	2016	2017	Krahasimi
1.	Individual	34,082	44,292	▲
2.	Bizneset	18,929	19,524	▲
	Totali	53,011	63,811	

Bazuar në të dhënat e raportuara nga operatorët për vitin 2017, rezulton se janë rreth 63,816 përdorues aktivë të shërbimeve të telefonisë fikse, që tregon rritje të konsiderueshme të numrit të parapaguesve, me afërsisht 10,805 parapagues apo rreth 20.3 % ,në raport me vitin 2016.

Telekomi i Kosovës si operator vazhdon të kontrolloj mbi 50% të tregut të shprehur me numrin e parapaguesve, përkatësisht 70% në bazë të të hyrave të realizuara përmes ofrimit të këtyre shërbimeve, gjersa operatori alternativ i shërbimeve të telefonisë fikse, IPKO ka shënuar rritje të lehtë në raport me 2016 sa i përket numrit të përdoruesve përkatësisht të hyrave që aktualisht rezulton me pjesëmarrje në treg prej 13% të numrit të përdoruesve, respektivisht mbi 8% për nga të hyrat. Gjersa Kujtesa Net ka një prezencë të vogël në këtë treg, por që në vitin 2016 vërehet rritje e lehtë.

Megjithat në përgjithësi, përdorimi i telefonisë fikse është në rënie të vazhdueshme. Kjo dukuri është rezultat i zëvendësimit përkatësisht trendit gjithnjë në rritje të përdorimit të telefonisë mobile veçanërisht përdorimi i telefonave mobil të mençur “smartphone” në raport me përdorimin e shërbimeve të telefonisë fikse.

Po ashtu, ofertat me tarifa shumë të leverdishme për qasje në internet nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile, kanë ndikuar që konsumatorët të zëvendësojnë shërbimet e telefonisë fikse me ato të telefonisë mobile e posaqërisht me ato të ofruara pa pagesë përmes përdorimit të shërbimeve të ashtuqujtura ‘over the top services OTT’.

Në vitin 2017, nga rrjetet fikse janë origjinuar rreth 54 milionë minuta të cilat paraqesin një rënie prej 5.11% në krahasim me vitin 2016.

Pjesën më të madhe të trafikut të përgjithshëm në rrjetin e telefonisë fikse e përbën trafiku i origjinuar dhe terminuar brenda rrjetit me rreth 48% e trafikut, 2% trafik drejt rrjeteve tjera fikse kurse pjesën tjetër të trafikut kombëtar e përbën trafiku drejt rrjetit mobil me rreth 41% si dhe pjesën e mbetur ai ndërkombëtar me rreth 9%.

III. Telefonia Mobile

Aktualisht në Kosovë operojnë dy operatorë të autorizuar të rrjetave të telefonisë mobile në brezin frekuencor;

- Telekom i Kosovës Sh.A/Vala
- IPKO Telecommunications LLC

Krahas dy operatorëve të autorizuar të rrjetave MNO (Mobile Network Operator) të përmendur më lartë, janë licensuar edhe dy operatorë tjerë mobil virtual (MVNO):

- Dardafon.net LLC (Z Mobile)
- Dukagjini Telecommunications sh.a. (D3 mobile) .

TRAFIKU I ORIGJINUAR NGA RRJETET E TELEFONISË MOBILE 2016-2017

Nr:	Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi 2016-2017
1	Totali i trafikut të origjinar MNO dhe MVNO	982,825	970,325	1.25 ▲
2	Brenda rrjetit	801,925	852,826	5.97 ▼
3	Drejt rrjetit tjetër mobil (mobil off-net)	129,722	99,630	30.20 ▲
4	Drejt rrjetit fiks	7,647	7,235	5.70 ▲
5	Drejt rrjetit ndërkombëtar	43,531	10,634	309.36 ▲

TRAFIKU I TERMINUAR NË RRJETET E TELEFONISË MOBILE (2016-2017)

Nr:	Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi 2016-2017
1	Totali i trafikut të terminuar	179,267	270,709	33.78 ▼
2	Prej rrjetit tjetër mobil (mobil off-net)	113,231	177,803	36.32 ▼
3	Prej rrjetit fiks	21,534	24,082	10.58 ▼
4	Prej rrjetit ndërkombëtar	44,502	68,824	35.34 ▼

PËRDORIMI MESATAR I SHËRBIMEVE TE TELEFONISË MOBILE PËR NJË PËRDORUES (2016 - 2017)

Nr:	Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi 2016–2017
1	Thirrje dalëse (të realizuara) në muaj	40	40	-
2	Thirrje hyrëse (të pranuar) në muaj	39	46	▼
3	MoU	79	86	▼
4	SMS (dalëse) në muaj	7	11	▼

Gjatë vitit 2017, numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur shifrën prej 2,032,182 (TM4 2017), që krahasuar me fundin e vitit 2016 numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka shënuar rritje prej 22,234 përdoruesish ose shprehur në përqindje paraqet një rritje prej 1.1%. Kjo është një rritje dukshëm më e vogël në krahasim me rritjen e vitit të kaluar.

Të ardhurat totale nga ofrimi i shërbimeve të telefonisë mobile nga operatorët mobil gjatë vitit 2017 janë 108.8 milionë EUR, të cilat shënojnë një rënie të lehtë në krahasim me vitin paraprak (2016), kur të ardhurat ishin rreth 112.3 milionë EUR.

IV. Interneti

Qasja në internet ofrohet nga 52 ndërmarrje të autorizuar, 4 prej tyre kanë qasje të drejtpërdrejtë në daljet ndërkombëtare ‘International Gateëay’, të cilat ofrojnë qasje në rrjetin e internetit të ISP-ve më të vogla, e që veprojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Sikurse edhe në vitet tjera e posaçërisht gjatë dy viteve të fundit, shërbimet brez-gjera ‘broadband’ të Internetit vazhdojnë të kenë rritje të numrit të përdoruesve. Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të vitit 2017 të raportuara nga operatorët, numri i familjeve që kanë qasje në internet brezëgjërë është afërsisht 92.8%. Bazuar në këto të dhëna, penetrimi i internetit në vitin 2017 për banorë rezulton të jetë rreth 15.1%. Krahasuar me vendet rajonale, Kosova ka një rritje të kënaqshme të penetrimit të shërbimeve brezgjëra.

Sa i përket segmentit të ofrimit të shërbimeve të internetit, në fund të vitit 2017, numri i përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e internetit përmes qasjes fikse ka arritur në 274,743 përdorues dhe që shënon rritje të konsiderueshme të përdoruesve prej 35,351 ose shprehur në përqindje rritja është 14.7% në krahasim me vitin e kaluar (2016). Sa i përket, qasjes në internet përmes rrjetit mobil (Mobile Broadband) 3G dhe 4G, numri i përdoruesve aktivë që janë qasur në internet përmes këtyre dy teknologjive vazhdimisht është duke u rritur, ky numër në fund të vitit 2017 ka arritur në 1,538,751 përdoruesish e që shënon një rritje për 41.9 % krahasuar me vitin 2016.

Trafiku i përgjithshëm i internetit ofrohet nga 4 operatorët të internetit të Kosovës (KOS-IX) të themeluar si njësi teknike pranë Autoritetit me qasje në rrjetin ndërkombëtare; Telekom i Kosovës, IPKO Telecommunication, Kujtesa Net dhe NTSH Art motion. Totali i trafikut të internetit nga këta operator është 154 Gbps.

Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit

Nr:	Kompanit	2016	2017	Diferenca 2016-2017
1	Ipko	47%	47%	/
2	Kujtesa net	25%	25%	/
3	Telekomi i Kosovës	16%	16%	/
4.	Të tjera	12%	12%	/

V. Pasqyra e përgjithshme e tregut të shërbimeve postare

Shërbime postare në territorin e Republikës së Kosovës mund të ofrojnë personat fizik dhe juridik, të cilët janë të pajisur me licencë nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronik dhe Postare (ARKEP) i cili është i autorizuar të lëshoj dhe tërheqë licencat operatorëve postar të cilët dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare.

Indikatorët kryesor matës të tregut të shërbimeve postare të cilët janë marrë për bazë janë: të dhënat mbi aktivitetet, volumin e dërgesave postare, të dhënat mbi të hyrat financiare në sektorin postar, të dhënat për kualitetin - cilësinë e realizimit të shërbimeve postare, të dhënat mbi numrin e të punësuarve në sektorin postar, infrastrukturën dhe rrjetin postar etj.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga ARKEP-i, për periudhën; Janar – Dhjetor 2017, krahasur me periudhën e një të vitit 2016, rezulton se kemi një rënie të theksuar të numrit të përgjithshëm të dërgesave postare në vlerën; 39.66 %, përderisa NPQ ‘Posta Kosovës SHA’, ka një rënie mjaft të theksuar të volumit të dërgesave postare dhe atë në vlerën; 45.45 %, ndërsa operatorët privat kanë një rritje të lartë në vlerën; 103.95 %. NPQ ‘Posta Kosovës SHA’, me 86.90 %, mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare kurse operatorët privat janë të përfaqësuar në vlerën; 13.10% të tregut të përgjithshëm.

Edhe përkundër rënies së numrit të përgjithshëm të dërgesave postare në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, sektori i shërbimeve postare ka të evidentuar rritje të hyrave të përgjithshme në vlerën; 6.49 %, përderisa NPQ ‘Posta e Kosovës SHA’, ka një rënie të lehtë në vlerën; 6.23 %, ndërsa operatorët privat kanë patur një rritje të theksuar të hyrave në vlerën; 32.47 %.

Vërehet se sektori i shërbimit postar në vitin 2017, ka pasur një rritje të theksuar të të hyrave të përgjithshme nga ofrimi i shërbimeve postare.

VI. Kuadri Ligjor.

1. Ligji për Komunikimet elektronik 04/L-109
2. Ligji për shërbimet postare 03/L-085
3. Ligji për shërbimet e shoqërisë informatike 04/L-094

VII. Pengesat e hyrjes në treg

Pozita monopoliste e një operatori mund të vihet nën presion nga operatorë/ofrues të tjerë, nëse do të ishte e mundur hyrja e tyre në treg. Mundësitë që operatorët tjerë të hyjnë në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin e një operatori mobil nuk ekzistojnë për shkak të kufizimeve teknike (p.sh. informatat e SIM kartelës, aparate / telefonat mobil, kontratat, etj.).

Në mënyrë që operator tjerë të ofrojnë shërbimin e terminimit të thirrjeve për përdoruesit e një operatori mobil, operatori i parë duhet që të ketë qasje në kartën SIM të përdoruesve të operatorit të fundit e që kjo mundesi nuk ekziston për ofrimin e terminimit të asnjë lloj operatori rrjeti mobil apo fiks.

Gjetja e mundësive më të mira për sektorin e telekomunikacionit

Aftësia e të gjithë sektorëve në botë për të zhvilluar infrastrukturën e tyre teknologjike dhe për të përsosur përvojën e tyre të konsumatorëve, është shfaqur si një parakusht thelbësor për konkurrencën e tyre. Për sektorin e telekomunikacionit, teknologjia është kushti i vetëm për ekzistencën. Infrastruktura teknologjike dhe cilësia e shërbimit janë prioritetet kryesore të sektorit të telekomunikacionit në çdo kohë. Rritja e trafikut të rrjetit dhe numri i pajisjeve të ndërlidhura kërkojnë që sektori i telekomunikacionit të jetë përpara të gjithë sektorëve. Sigurimi i shpejtësisë dhe brezit të nevojshëm, përmirësimi i rrjeteve të tyre në teknologjinë 5G, mbajtja e numrit të klientëve në të njëjtën kohë me të gjitha këto investime dhe mos komprometimi i eksperiencës më të mirë të konsumatorëve duhet të jenë hapat e parë të sektorit të telekomunikacionit. Investimet drejtpërsëdrejti ndikojnë në përvojën e konsumatorit dhe përvoja e konsumatorit ndikon drejtpërdrejt në pjesën e tregut.

Të dhënat e mëdha, që janë fokusi i gjithë botës, kanë një kuptim të ndryshëm për kompanitë e telekomunikacionit. Për më tepër, duhet të theksohet se sektori i telekomunikacionit siguroi formimin e një pjese të konsiderueshme të të dhënave të mëdha. Të gjitha zgjidhjet që do të mbajnë sektorin e telekomunikacionit në të ardhmen varen nga analiza e përpiktë e këtyre të dhënave dhe përfshirja e saj në sistem.

Teknologjitë mobile, teknologjia cloud, Interneti, inteligjenca artificiale, pagesat digjitale dhe analiza e të dhënave të mëdha janë baza e të gjitha zgjidhjeve inovative. Prandaj, sektori i telekomunikacionit nuk ka luksin e të menduarit tradicional. Në vizionin që bota do të lidhet me njëri tjetrin, shqetësimet e sigurisë kibernetike që dalin nga kaosi gjeopolitik janë kritike. Kompanitë e telekomunikacionit janë përgjegjës për të gjitha lidhjet personale, komerciale dhe zyrtare përmes rrjeteve të tyre. Aplikacionet e qeverisjes elektronike, sistemet bankare, duke folur me njëri-tjetrin, pajisjet mjekësore,

sistemet digjitale të prodhimit, mjetet me teknologji lidhëse në mjedisin e së ardhmes, për të siguruar sigurinë e rrjeteve, rrjetave të mundshme të rrjedhjes dhe të rezistencës për të krijuar, për t'iu përgjigjur shpejt problemeve dhe për të zhvilluar metodat e nevojshme të mbrojtjes janë ndër tiparet e pritshme të infrastrukturës së kompanisë së telekomunikacionit.

Kjo është ana e kompanive të telekomunikacionit që duhet të drejtohen. Nevojat e rrjetit të pothuajse të gjithë sektorëve, vendeve dhe institucioneve po rriten. Së paku, njerëzit në botë në vitin 2018 janë të fokusuar në komunikimin vizual, duke marrë fotografi dhe video, duke shkarkuar, modifikuar, pasuruar dhe ndarë. Si ato popullore për shperndarjen e fotografive Instagram ka më shumë se 800 milionë përdorues aktivë. Numri i fotove dhe videove të ngarkuara është mbi 100 milionë në ditë. Numri i shikimeve të përmbajtjes së videos është 5 herë më shumë se ato normale. Këto tendenca na tregojnë qartë se bota është tashmë gati për teknologjinë 5G, e cila pritet të rrisë shpejtësinë e shkarkimit në 10 GB për sekondë.

Në dritën e gjithë këtij informacioni, ne besojmë se sektori i telekomunikacionit në Kosovë do të vazhdojë të rritet për vitet në vijim. Ne parashikojmë që tregu celular do të vazhdojë të rritet, dhe se kërkesa e të dhënave do të vazhdojë të rritet. Sidoqoftë, mjetet tradicionale të komunikimit pritet të vazhdojnë të bllokojnë përdorimin e telefonave fiks.

Për të përmbushur këtë rritje, operatorët do të vazhdojnë të investojnë në infrastrukturë, por me studimet e optimizimit dhe efikasitetit, efikasiteti i investimeve do të rritet. Përveç modeleve tradicionale të biznesit të kompanive të telekomit, ne mendojmë se do të zhvillojnë produkte dhe shërbime të reja duke bashkëpunuar me kompani nga sektorë të ndryshëm dhe të përqëndrohen në teknologjitë që krijojnë përvoja që transformojnë konsumatorët jo vetëm duke iu përgjigjur nevojave aktuale të klientëve të tyre.

Suksesi i këtyre zhvillimeve do të përcaktohet jo vetëm nga suksesi i produkteve dhe shërbimeve të kompanive, por edhe nga shpejtësia e përshtatjes së përdoruesve. Në 2018, kërkesa e klientëve për integrimin e teknologjisë pritet të rritet. Me rritjen e prodhimit të të dhënave të ndërmarrjeve, përdorimi i qendrës së të dhënave me bazë cloud do të bëhet i përhapur.

Për më tepër, jo vetëm ruajtja e këtyre të dhënave, por edhe analiza dhe marrja e informacionit kuptimplotë, ofron një mundësi për ndërmarrjet që të bëjnë dallime në sektorët ku ka konkurrencë të fortë. Megjithatë, sfida nuk është të ruajë të dhënat, por të analizojë, grupojë dhe të marrë informacionin në dispozicion. Përveç analizave të të dhënave, internetit të gjërave dhe përdorimit të inteligjencës artificiale; Duke përdorur këto teknologji shkatërruese, bizneset krijojnë mundësi për të transformuar tregun në të cilin ato veprojnë dhe nxisin konkurrentët e tyre. Roli i kompanive të telekomunikacionit

do të jetë për t'iu përgjigjur kësaj nevoje në treg dhe për të drejtuar klientët në këtë drejtim duke shkuar përtej metodave tradicionale të biznesit.

Në vitin 2017 ne mendojmë se kompanitë e telekomunikacionit do të rrisin iniciativa të tilla. Ndryshimi në zakonet e shikimit televiziv është një çështje tjetër që ka të bëjë me sektorin e telekomunikacionit.

Konsumatori dëshiron të arrijë përmbajtjen e dëshiruar në çdo kohë. Me pamjaftueshmërinë e programeve të prodhuara në kanalet tradicionale dhe nevojën për qasje të menjëhershme në përmbajtjen globale, është rritur interesimi për kanalet që transmetohen në internet.

VIII. Konstatim

- Tregu i komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në përgjithësi është konkurrues, në veçanti tregu i telefonisë fikse edhe përkundër se kemi një operator me pozitë dominuese megjithatë, tregu është i rregulluar nga ARKEP duke vendosur detyrime rregullatore.
- Tregu i telefonisë mobile edhe përkundër përqendrimit të tregut në dy operator të rrjetit megjithatë tregu është konkurrues në nivel shërbimi, duke pas parasysh faktin se ekzistojnë dy operator virtual (MVNO) ku njëri prej tyre është mjaft aktiv në treg. Si dhe prezenca e operatorit me infrastrukturë të kufizuar kontribuon që ky treg të jetë deri në një masë konkurrues.
- Telekomit i Kosovës ka pozitë më të mirë në tregun e telefonisë mobile në Kosovë (sa i përket kriterëve të madhësisë dhe të pjesëmarrjes së tregut), por në anën tjetër IPKO edhe pse si operatori më i ri ka arritur mjaft mirë ta konsolidoj pozitën e saj në treg.
- Të dy MNO-të (Telekomi i Kosovës dhe IPKO) kanë aftësinë dhe nxitjen/motivin për të penguar/bllokuar konkurrencën e tregut në nivel me pakicë, duke mos lejuar qasje për hyrësit e ri në treg (si për shërbimet fikse ose mobile) ose për të bërë këtë qasje sa më shumë të paqartë, kushte diskriminuese dhe joproporcionale. Prandaj detyrimet si ai i qasjes, së bashku me atë të transparencës dhe mosdiskriminimit mund të vendosen;
- Të dy MNO-të në mungesë të një rregullimi adekuat, kanë aftësinë dhe nxitjen/motivin për të aplikuar kushte diskriminuese për terminim të thirrjeve mobile (përfshirë edhe çmimin). Prandaj detyrimi i mos-diskriminimit duhet të imponohet.

- Mirëpo, duke pas parasysh faktin se ka brez të mjaftueshëm frekuencor, rekomandojmë që ky brez të hapet dhe të mundësohet zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjeteve dhe shërbimeve, i cili do të ndikoj në dinamizmin e mëtutjeshëm të këtij tregu.
- Tregu i shërbimeve të internetit konsiderohet si treg konkurrues në nivel të infrastrukturës pasi që secili operator ofrimin e shërbimeve e bazon në infrastrukturën vetanake (mbi 54 oper).
- Megjithatë marr parasysh konvergjencën e teknologjive e cila mundëson ofrimin e shërbimeve në pako atëherë çështja është e ndjeshme kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve të internetit në pako me shërbimet e transmetimit të përmbajtjes, rasti të tillë kemi tek operatori Ipko, I cili ofron internet dhe transmetim të përmbajtjes në bazë të marrëveshjes ekskluzive në mes të Ipkos dhe DigitAlb e që rrjedhimisht ka ndikim në tregun e shërbimeve të internetit.
- Një analizë e tregut në sektorin e telekomunikacionit është kryer me qëllim për të parë strukturën dhe dinamikën e atij tregu. Për nevojat e analizës jemi referuar të dhënave nga rregullatori I sektorit përkatës për periudhën 2016-2017. Sektori i telekomunikacionit karakterizohet jo vetëm si faktor i zhvillimit ekonomik, por edhe si stimulues në zhvillimin e ekonomive të tjera, me theks tek sektori i inovacioneve dhe shoqërisë së informacionit. Struktura e tregut dhe pjesët e tregut mbetën relativisht e qëndrueshme në periudhën e monitoruar.
- Duke pasur parasysh rëndësinë tregu i komunikimeve elektronike vazhdon me trende pozitive, në disa segmente të tij, siç është rritja e numrit të përdoruesve të shërbimeve mobile dhe të internetit, Autoriteti konstaton se mbizotron një ambient konkurrues, dhe në të ardhmen do të monitorojnë me kujdes sjelljen e pjesëmarrësve në treg dhe rrethanat që ata mund të bijnë ndesh me Ligjin për Mbrotjen e konkurrencës.